



Prishtinë, 04 tetor 2021
Kodi i ZRRE-së: V_1415_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenin 19, 20 dhe 21 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja;
- Vendimin për lëshimin e Autorizimit Final V_760_2016 të datës 28 janar 2016 lëshuar shoqërisë "Matkos Group" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, në Lokacionin Shtërpce me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, ZK Shtërpce, komuna e Shtërpçës; dhe
- Kërkesën për Modifikimin të Autorizimit Final V_760_2016 të datës 28 janar 2016 për Modifikimin zvogëlimin e kapacitetit instalues nga 5.031 MW në 4.9 MW ZK Shtërpce, komuna e Shtërpçës, të datës 23.02.2021 të shoqërisë "Matkos Group" SH.P.K., me adresë rruga "Veternik" pn. Prishtinë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 04 tetor 2021 nxori këtë:

V E N D I M
PËR MODIFIKIM TË AUTORIZIMIT FINAL

- I. **APROVOHET** – kërkesa e shoqërisë "Matkos Group" SH.P.K., dhe **MODIFIKOHET VENDIMI PËR AUTORIZIMIT FINAL V_760_2016** të datës 28 janar 2016 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, me të cilën modifikohet/zvogëlohet kapaciteti instalues nga 5.031 MW në 4.9 MW ZK Shtërpce, Komuna e Shtërpçës, sipas Vendimit për Leje Ujore Nr. 102/21 i datës 09.02.2021, i lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.

A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 23 shkurt 2021 nga shoqëria "Matkos Group" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për Modifikimin e Autorizimit Final V_760_2016 të datës 28 janar 2016 për Modifikimin zvogëlimin e kapacitetit instalues nga 5.031 MW në 4.9 MW ZK ZK Shtërpce, komuna e Shtërpçës.
- o ZRRE s' bashku me kërkesës për Modifikim të Autorizimit Final ka pranuar edhe Vendimit për Leje Ujore nr. 102/21 i datës 09.02.2021, i lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, Pëlqimi Elektroenergjetik (Revidim) për kapacitetin 4.9 MW i datës 21.04.2021 i lëshuar nga KEDS, Raportin Teknik mbi pranimin teknik të datës 06.05.2021 të lëshuar nga KEDS dhe Certifikata e përdorimit Nr. 06-351/02-13294/20 e datës 11.12.2020 e lëshuar nga Komuna e Shtërpçës.



- Shoqëria "Matkos Group" SH.P.K., në kërkesën e saj ka sqaruar se, kërkesa për modifikim të autorizimit final është parashtruar pasi që ndryshimi dhe zvogëlimi i turbinës është bërë sipas Lejes Ujore të Lëshuar nga Ministria e Ambientit, me të cilën është aprovuar e drejta e shfrytëzimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike nga HC Shtërpcë, me kapacitet prej 4.9 MW, për shfrytëzimin e potencialit hidrologjik në degët e segmentit lumor të Lumit Lepenc, nga kuota 1420 m.l.m (dega 2-x= 7506423; y=4674378) deri në kuotën 914 m.l.m (HC – x= 7502631; y=4676493), sipas kushteve të dhënuara me leje.
- Poashtu ka sqaruar se janë plotësuar të gjitha kushtet teknike të kërkuara nga Leja e Ndërtimit ku është siguruar certifikata e përdorimit e lëshuar nga Komuna e Shtërpcës dhe kushtet teknike të kyçjes sipas pëlqimit elektroenergjetik të vërtetuara me pranimin teknik të lëshuar nga KEDS.
- Andaj, bazuar në këtë që tha më lartë dhe dokumentet e bashkangjitura në mbështetje të kërkesave ligjore, kanë kërkuar nga Bordi i ZRRE-së, që të aprovon modifikimin e autorizimit final pasi që kapaciteti instalues është zvogëluar.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të kërkesës për Modifikim të Autorizimit dhe dëshmime të bashkangjitura, ka vlerësuar ato, dhe ka konstatuar se kërkesa për modifikim është e bazuar në dispozitat ligjore të Nenit 19 të Rregullës së Autorizimit, dhe dëshmitë e bashkangjitura janë bazë e mjaftueshme për të lejuar modifikimin e autorizimit Final V_760_2016 të datës 28 janar 2016, për zvogëlimin e kapacitetit instalues nga 5.031 MW në 4.9 MW ZK ZK Shtërpce, komuna e Shtërpcës, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Shtërpcës,
- KEDS SH.A.,
- KESCO dhe
- Arkivit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar